



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 176, Datë 26.10.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR NDËRMJET
SHOQËRISË ALBGAZ SH.A DHE ALBPETROL SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” neneve 35 dhe 36 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”; nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë albgaz sh.a dhe albpetrol sh.a.

Konstatohet se:

- Shoqëria "Albgaz sh.a", ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror në Shqipëri, në zbatim të VKM nr. 848, datë 07.12.2016 për "*Krijimin e Shoqërisë Albgaz sh.a dhe për caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a*".
- Bordi i ERE me vendimin nr. 82, datë 26.05.2017 ka miratuar Certifikimin Paraparak të shoqërisë “Albgaz” sh.a në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror dhe me vendimin nr. 90, datë 07.06.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”, ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.09.2017.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 127 datë 16.08.2017, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.
- ERE ka marrë dijeni për draftimin e kësaj kontrate me shkresën e “Albgaz” sh.a nr. 23 Prot., datë 03.04.2017.

- Me shkresën nr. 107 Prot., datë 09.10.2017 shoqëria Albgaz sh.a i është drejtuar ERE për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes midis Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a.
2. Drejtoria e e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI